

Mekatronika është bërë çelës për shumë prodhime dhe shërbime në industri. Sistemet moderne sot e kanë arritur nivelin e përsosshmërisë, nivel të cilin ka qenë vështirë ta imagjinojmë me përdorimin e teknologjive tradicionale.



Mekatronika integron fushat klasike të inxhinierisë mekanike, elektrike, kompjuterike dhe teknologjinë informative për të realizuar praime bazë të metodologjisë bashkëkohore të sistemeve Mekatronike. Kurrikula për studimet baçelor në fushën e Mekatronikës mbështetë integrimin sinergjetik të inxhinierisë mekanike precize, dirigjimin elektronik dhe sistemet mekatronike, gjithnjë duke menduar në dizejnimin, realizimin, operimin dhe mirëmbajtjen e riparimin e sistemeve të linjave të automatizuara dhe shërbimeve "inteligjente".



Adresa: **Ruga Agim Ramadani, Ndërtesa e Fakulteteve Teknike 10000, Bregu i Diellit, Prishtinë, Republika e Kosovës**

fim@uni-pr.edu

+383(0)38 552 126 ext.

fim.uni-pr.edu

UNIVERSITETI I PRISHTINËS

“HASAN PRISHTINA”



FAKULTETI I INXHINIERISË

MEKANIKE

Departamenti:

Mekatronikë



Tregu i punës në Mekatronikë përfshin të gjithë sektorët e industrisë, si dhe kompanitë e angazhuara në:

- Automatizimin Inteligjent (konceptet moderne të programimit),
- Metodat dhe sistemet Mekatronike (Mekatronika përgjithshme, robotika industriale), robotika e avancuar (robotët e lëvizshëm dhe shërbyes),
- Prodhimin e sistemeve të ndryshme Mekatronikë.
- Prodhimtaria Inteligjente etj.

Të diplomuarit në studimet Baçelor në Mekatronikë, do të pajisen dhe aftësohen për tregun e punës në Kosovë dhe jashtë saj. Ata janë në gjendje të ofrojnë këto shërbime:

- Aftësi praktike në hartimin dhe zbatimin e sistemeve të kontrollit;
- Aftësi praktike në ruajtjen dhe përmirësimin e sistemeve ekzistuese për sistemet e kontrollit;
- Aftësi në aplikimin e sensorëve inteligjentë, përpunimin e sinjaleve digjitale dhe hartimin e bazës së të dhënave;
- Aftësi në programim në gjuhën C, C++, Matlab, LabView dhe TIAPORTAL and SCADA PLC S7-300 S7-1200 dhe S7-1500;
- Aftësi në shfrytësimin e programeve aplikative CAD/CAM, SolidWorks, Inventor, Fusion Mechanical/Electrical në disenjimin e PCB-ve;
- Aftësi të përciptimit të teknologjive të reja.

Mundësitë e punësimit:

- Punon punë praktike në një sërë aplikacionesh dhe mjediseh për Automatizim, Fabrika Digjitale, Robotikë dhe Prodhim;
- Punon në industrinë e automobilave, mikro industri, industri kompjuterike për zbatimin efektiv të metodave dhe sistemeve Mekatronike;
- Institucionet e arsimit në nivele të ndryshme;
- Planifikim, projektim dhe zbatim të projekteve të nga fusha e Mekatronikës;
- Llogaritë, zbaton dhe punon në pranim/dorëzim të projekteve të plota në fushën e Teknologjisë së Mekatronikës;
- Punon në aplikimin dhe zhvillon metoda dhe mjete për modelim, optimizim dhe simulim të sistemeve Mekatronike.
- Organizim dhe menaxhim i proceseve tipike të biznesit në fushën e Teknologjisë së Mekatronikës.
- Mirëmbajtje e Sistemeve Inteligjente në Mekatronikë;
- Kompanitë prodhuese-industriale;

Zhvillimi i programeve të studimeve është i bazuar në kërkesat e tregut të punës. Pas përfundimit të studimeve hapen rrugët për punësime në tregun punës në vend dhe jashtë vendit, si dhe mundësia madhe e vazhimit të mëtejme të studimeve shkencore dhe profesionale.

Drejtimi i Mekatronikës ka mbi 10 vite punë dhe aktivitet shumë të rëndësishëm në aftësimin e kuadrove të reja nga lëmitë e Mekatronikës.

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT KA PËRFSHIRË PROGRAMIN E MEKATRONIKËS NË LISTËN E PROGRAMEVE TË VLEFSHME PËR THIRRJEN PËR VAJZAT/GRATË NË FUSHAT STEM, KU VAJZAT E REGJISTRUARA NË MEKATRONIKË PËRFITOJNË BURSË NË VLERË 1000 €.

Studimet organizohen në nivelin Bachelor dhe Master. Mësimi realizohet në formë të ligjëratave, ushtrimeve numerike, ushtrimeve laboratorike, projekteve nga Mekatronika, vizitave mësimore në terren, hulumtimeve, seminareve, mobiliteteve vendore dhe ndërkombëtare etj.

